

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DEGA NË DRAGASH**, si gjykatë penale e shkallës së parë nga gjyqtari Sabaheta Kurteshi, me sekretaren juridike Senida Nuri - punëtore e kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit **Sh. I. nga fsh..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KP-së**, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.709/14 të dt. 26.12.2014, pas mbajtës së shqyrtimit gjyqësor më dt. 29.05.2015, në praninë e prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren Elfete Purova, të dëmtuarit D. M. dhe të akuzuarit Sh I., mori dhe publikisht shpalli:

### A K T G J Y K I M

#### **Kundër të akuzuarit:**

**SH. I.**, nga i ati V., e ëma S. e lindur K., i lindur me..., në Prizren tani me vendbanim në fsh..., Komuna e Dragashit, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### LIROHET NGA AKUZA

Se me datë 26.02.2014, në orët të pacaktuar në fsh..., Komuna e Dragashit, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, merr pasurinë e luajtëshme të të dëmtuarit D. M., në atë mënyrë që shkon në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit (në të cilën ende nuk banon) dhe nga aty merr 7 (shtaë) copë profila të metalit dhe ik nga vendi i ngjarjes.

#### **Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KP-së.**

Për shkak se nuk është provuar që i akuzuari të ketë kryer kete veprë penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

### A r s y e t i m

Prokuria Themelore në Prizren me aktakuzën e tyre, PP/II.nr.794/14 të dt. 26.12.2014 të paraqitur kësaj gjykate me dt. 05.01.2015 ka akuzuar Sh. I. nga fsh..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KP-së.

Kjo gjykatë ka caktuar shqyrtimin fillestar ku i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i ngarkohet me aktakuzë dhe të njëjtin e ka udhëzuar për të drejtat e

tija për parashtrim të kërkesës për hüdhe të aktakuzës dhe kundërshtimit të provave, e që në fakt i pandehuri brenda afatit prej 30 dite si dhe pas shqyrtimit të dytë gjykatës nuk i ka afruar parashtrësë në formë të shkruar.

Me dt. 29.05.2015 gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor ku janë administruar provat, është dëgjuar i dëmtuari D. M. dhe në cilësi të dëshmitarit, është dëgjuar i akuzauri, janë lexuar dhe provat të paraqitura nga palët dhe atë: është lexuar kallëximi penale me nr. 2014-GD-51 të dt. 14.03.2014, raporti i oficerit të dt. 26.02.2014 si dhe është bërë shikimi në foto dokumentacion të përgatitur nga ana e SP në Dragash nga vendi i ngjarjes.

**Prokurori i shtetit** sikurse gjate shqyrtimeve gjyqësore po ashtu dhe ne fjalën e fundit ka ngel në tërësi pranë aktakuzës duke propozuar që i akuzuari te shpallet fajtor dhe te gjykohet sipas ligjit, ngase gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar si nga dekelrata e të dëmtuarit ashtu dhe në bazë të provave tjera.

**I demtuari D. M.** gjate shqyrtimit kryesor dhe ne fjalën e fundit si i dëmtuar i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe i parashtron kerkese pronesore juridike ndërsa si dëshmitar ka deklaruar: unë kam dhe një shtëpi të dytë e cila është ndërtuar dhe për momentin është e pabanuar dhe e njëjta edhe në momentin e rastit ka qen e pa banuar, oborri i shtëpisë është i rrethaur me profilat të hekurit me temel të çimentos dhe para se me ndodh rasti tek shtëpia kam qenë para 3-4 ditë dhe profilat kanë qen në vend, me datë 26.02.2014 kam shkuar prapë me shokunë tij E. Y. te shtëpia dhe kam vërejtur se temeli prej betonit është thyer në 5-6 vendë dhe janë nxjerë 8-9 profila ku 4 prej tyre kanë qen të dëmtuar – të këputur në fund afër betonit. Menjëherë e kam lajmëruar rastin në polici e cila erdhi në vend dhe bëri fotografimin e vendit. Shtëpia e re është larg shtëpisë ku banojmë – 400 m, afër shtëpisë e re ka shtëpitë të tjera të banueshme në një largësi të përafër prej 100 m. Para se të ndodhë rasti e kam pa të akuzuarin te varezat në largësi prej shtëpisë së re 60 m, kam biseduar me Sh. e i cili është sjellur keq dhe nuk është përgjegjur. Mëherët ka pasur dëm të tjera në këtë shtëpi si thyerje të dritareve të shtëpisë, prerja e kabllit të rrymës, dëmtimi i ujësjellsit, dëmtimi dhe marja e profileve që për këtë dyshon në të pandehuri se e ka kryer, dhe se vlera këtyre dëmeve në atë kohë ka qen përafërsisht 200,00 €. Ky dëm është shkaktuar shumë shpejt e jo gjatë luftës. Nga viti 1993 në fakt gjatë këtij viti sipas të dëmtuarit në shtëpinë e re janë kryer punët e vrazhta, ka dritare dhe dyer, instalimin e rrymës, ujësjellsin, është pa fasadë, është e ndërtuar me bllokat të kuqë të betonit dhe se rrethoja është e mbaruar qe nga viti 1993 dhe ashtu ka mbet deri me tani. Gjithashtu deklaroi se lidhur me vjedhjen e profileve dhe dëmtimin e tyre në fakt të rrethojës nga ana e këtu të pandehurit askush nga fshatarët nuk e ka përmend emërin e të pandehurit dhe se as vet nuk e ka pas kur i ka marr profilet dhe dëmtuar rrethojën dhe temelin dhe duhet të bëjë përmersim se unë të pandehurin nuk e kam pa afër shtëpisë së re – rrethojës para rastin qe ka ndodhë por dy ditë pas rastit dhe atë në një largësi nga shtëpia e re – rrethojës 60 m, tek vendi ku është stadioni i fshatit qe shërbën për futboll. Gjithashtu deklaroi se kohë pas kohe këtu i pandehuri shetë këso llojet mbeturinash si kabllat të rrymës, hekur, profila personave qe mbledhin mbeturinat, mirëpo nuk kam dëgjuar prej fshatarëve se profilat e tij këtu i dëmtuari ja ka shitë ndonjë personit.

**I akuzuari Sh. I.** ne brojtjen e tij sikurse ne hetime po ashtu edhe ne shqyrtimin kryesor dhe ne fjalen e fundit ka theksuar: unë shtëpinë e kam afër xhamisë së fshatit, por ka livadhe qe janë largë shtëpisë së të dëmtuarit praafërsisht rreth 100 m, dhe përmes kësaj prone të tij ka rrugë dhe kalon afër shtëpisë së të dëmtuarit. E di qe oborri i të dëmtuarit është i rrethuar me beton dhe në beton janë të ngulura profilat e hekurit. Afër shtëpisë së D. është stadioni ku kohë pas kohe shkon vetëm si shikues ndërsa ka shtëpia e të dëmtuarit në fakt në shtëpinë e të dëmtuarit ka qen përpara kur ka pas muhabet me D. sepse tash raportet i kanë jo të mira për arsye se i dëmtuari podyshon tek une për profilet. Kohë pas kohe shkon tel livadhi i vet, ndonjëherë shkon me shok që të luaj futboll dhe se për rastin ka dëgjuar vetëm kur është ftuar në polici e jo prej fshatarëve, dhe se nuk ka shku tek D. se është frekësuar se do ta sulmoj sepse më parë e ka sulmuar me shkop druri. Lidhur me ndonjë rast tjetër paraqitur në gjykatë gjithmon jam liruar si i pafajshëm. Unë jam punëtor krahu, nuk merëm me tregëti, nuk kam shitur asnjëherë ndonjë material ndërtimor si kabëll të rrymës. Nuk e pranon fajësinë për veprën penale se nuk është e vërtet qe i ka thyer profilet, i ka marr dhe se nuk është e vërtet se i ka dëmtuar betonin siç thotë i dëmtuari.

Me administrimin e provaveqe gjinden nëshkresat e lëndës, provave tjera të propozuara nga palët si me dëgjimin e të dëmtuarit edhe në cilësi të dëshmitarit, fjalën mbrojtëse e të akuzaurit gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimit me arsyetim:

Nga deponimet e te demtuarit – deklaratës së tij si dëshmitar nuk është kontestuese dhe se është vërtetuar se i është dëmtuar rrethoja prej profilave të hekurit dhe temeli prej betoni, mirëpo në bazë të provave të administruara dhe vet deklaratës së të dëmtuarit gjykata nuk ka arit që të vërtetoi se kush është kryesi i veprës penale për arsye se në asnjë pjesë të deklaratës së të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nuk është vërtetu se i dëmtuari e ka takuar në vend ngjarje duke e dëmtuar rrethojën e shtëpisë dhe temelin prej betoni këtu nga ana e të akuzuarit, askush nga fshatarët nuk e ka akuzuar të pandehurin Sh. se i njëjti është fajtor dhe kryes në fakt kryesi i dëmtimit të rrethojës së shtëpisë së re të dëmtuarit, nuk është pa nga askush prej fshatarëve por edhe vet nga i dëmtuari se i pandehuri ka bërë shitje e materialit të vjedhur këtu profilave ku këtë e ka thënë dhe vet i dëmtuari.

Faktin se këtu i dëmtuari dyshon në të pandehurin gjykata nuk e merr për bazë dhe deklaratës së të dëmtuarit nuk i falë besimin dhe nuk e pranon si të bazaur sepse në asnjë mënyrë i dëmtuari nuk ka arrit qe ta bind gjykatën se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.

Me administrimin e provave dhe atë kallëzimin penal, raportit të oficerit foto dokumentacionit nga vendi i ngjarjes gjykata ka vërtetuar se është bërë dëmtimi i rrethojës së metalit – prej profilave të hekurit dhe temelit prej betoni dhe marrjes së 4 profileve, mirëpo nuk është vërtetuar se këtu i pandehuri Sh. e ka dëmtuar këtë rrethojë, i ka thyer dhe vjedhë 4 profila dhe të njëjtit kinse i ka shitur, sepse policia e Kosovës nuk ka gjetur ndonjë provë si gjurmë të gishtrinjëve, ndonjë dëshmi të marr nga ndonjë fshatar se është vërejtur këtu i pandehuri duke bërë dëmtimin e rrethojës.

Sa i për këtë deklaratës së të dëmtuarit se i akuzuari është hasur pas dy dite afër shtëpisë së tij në largësi prej 60 m, afër vorrezave këtu i akuzuari e ka arsyetuar se afër

vorezave e ka pronën e vet – livadhi është stadioni i futbollit e i cili me shok të tijë e shfrytëzojnë për lojë.

Mbrojtjes së të akuzuarit ku i njëjti nuk e paranon fajësinë për veprën penale që i ngarkohet me arsyetim në fjalën mbrojtëse të tij si më lart gjykata i falë besimin dhe e pranon si të bazuar sepse në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar as nga ana të dëmtuarit por edhe nga ana e policisë së Kosovës në fakt paraqitësit të aktakuzës me asnjë provë se këtu i akuzuari ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KP-së.

Andaj, gjykata pas analizës dhe vlerësimit të të gjitha provave se bashku dhe të seciles veq e veq gjeti se nuk ka prova qe provojnë që veprimet e të akuzuarit permbajnë elemente të veprës penale, vjedhje nga neni 325 par. 1 të KP-së, meqe nuk është vërtetuar se i akuzuari ka dëmtuar rrethojën prej profilave të hekurit, një pjesë të temelit prej betoni dhe vjedhjen e 4 profilave, sepse i akuzuari nuk është hasur në vend ngjarje qoft nga i dëmtuari apo nga dikush tjetër – në flagrancë, por askuksh nga fshatarët nuk ka deklaruar se dyshojnë në të akuzuarin për këtë vepër penale ku këtë e ka thënë vet i dëmtuari.

Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjyimit konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform dispozitave ligjore.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - DEGA NË DRAGASH**  
**P.nr.1/15 të dt. 29.05.2015.**

**Sekretare Juridike :**  
**Senida Nuri**

**Gj y q t a r i :**  
**Sabaheta Kurteshi**

**UDHZIME JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të Aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.